

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15894200-0

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 3,923,750 (tre milion e nentëqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr. 100 datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.283, datë 19.3.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojmë Neni 83 1 LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paragjithësi të sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e

procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, Neni 82. 1 LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për piesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ase palë të treta, formularin përmbledhës të vendklarimit, xipat parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e proburimit puNik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 9 të DST-s

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa b), të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël për katësearrinose e kalon shumë prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të

të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/h, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare" si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 283, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2. gërma di dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të

identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë **jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i projektit të realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i projektit të realizuar, si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara ne organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat, si dhe objekti i projektit të realizuar.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi për të dëshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë Licencën e kategorisë **“II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” (katering)**, të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Kjo licencë duhet të korrespondojë saktësisht me adresën fizike të kuzhinës ku do të kryhet procesi i gatimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore. Liçenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 1 (një) ambient për prodhimin e ushqimit, i cili duhet të ndodhet brenda territorit të Bashkisë Tiranë.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë, kontratën e qirasë ose të përdorimit, ku të identifikohet qartë adresa brenda territorit të Bashkisë Tiranë, si dhe afati i vlefshmërisë, i cili duhet të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës që është objekt prokurimi.

Argumentimi: *Referuar termave të referencës pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit, si edhe të administruara në dosjen e procedurës është përcaktuar se ofertuesi do të përgatisë ushqimin sipas vakteve edhe menusë së përcaktuar paraprakisht nga AK dhe për realizimin e këtij procesi ofertuesit e mundshëm ekonomik duhet të kenë një ambient për realizimin e këtij shërbimi ç'ka do të sillte detyrimisht realizimin me sukses të kontratës edhe gjithashtu disponimi i lejes higjieno sanitare garanton sërish AK, se ky proces do të kryhet në parametrat e duhura higjienike pa ekzistuar rreziku i kontaminimit të ushqimit dhe si pasojë kjo të derivojë në rrezikshmëri për jetën e konsumatorit në rastin konkret të personave në situatë rruge fokus i përditshëm i kësaj qendre.*

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin raportin e inspektimit të fundit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), i cili vërteton se veprimtaria e tyre ushtrohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi. Ky dokument nuk duhet të përmbajë masa administrative apo pezullime aktive të aktivitetit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur konform përcaktimit të bërë në rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së Nr 10181 prot dt 19.11.2018 i cili i shërben Autoritetit për t'i ofruar besueshmërinë dhe sigurinë se aktiviteti i ofertuesit të mundshëm është konform kërkesave ligjore dhe është kryer konform standarteve në fuqi për sigurinë ushqimore.*

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim AKU-je për 3 muajt e fundit i cili vërteton se veprimtaria e tyre ushtrohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur konform përcaktimit të bërë në rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së Nr 10181 prot dt 19.11.2018 i cili i shërben Autoritetit për t'i*

ofruar besueshmërinë dhe sigurinë se aktiviteti i ofertuesit të mundshëm është konform kërkesave ligjore dhe është kryer konform standarteve në fuqi për sigurinë ushqimore.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

- Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente/të barazvlefshme – Standart për “Sistemin e menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- Certifikatë ISO 22000:2018 ekuivalente/të barazvlefshme, certifikatë e sistemit të Menaxhimit të sigurisë Ushqimore (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), ku citohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie”, si në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. nga Standarti ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që, operatori pjesëmarrës të provojë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe

kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së . Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si: çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës. ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.

Standarti ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

- Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor
- Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete);
- Menaxhim sistematik;
- Programet e nevojshme;
- Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP); Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:
- Fokus ndaj klientit;
- Angazhimi i menaxhimit të lartë;
- Pjesëmarrje aktive e personelit;
- Qasje ndaj procesit;
- Përmirësim i vazhdueshëm;
- Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion;
- Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara;

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

- Çertifikatë të menaxhimit për sigurinë ushqimore sipas konformitetit me standartet evropiane (HACCP).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën (HACCP).

Argumentimi: Standarti evropian (HACCP) është një mënyrë për të menaxhuar rreziqet e sigurisë ushqimore. Procedurat e menaxhimit të sigurisë ushqimore duhet të bazohen në parimet HACCP (Analizës së rrezikut dhe pikave kritike të kontrollit). HACCP iu shërben operatorëve ekonomikë për identifikimin e çdo pike kontrolli kritike apo zonat ku një operator duhet të fokusohet për të siguruar që këto rreziqe të hiqen ose të reduktohen në nivele të sigurta duke vendosur se çfarë veprimi duhet të ndërmerret nëse diçka shkon keq. Një rrezik ushqimor është diçka që mund ta bëjë ushqimin të pasigurt ose të papërshtatshëm për t'u ngrënë. Është e rëndësishme që OE të

identifikojnë kur rreziqet mund të jenë të pranishme, në mënyrë që ato të hiqen ose të reduktohen në nivele të sigurta.

2.3.8 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë të punësuar stafin e mëposhtëm minimumi pwr muajine fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Drejtues Teknik/Përgjegjës shërbimi <u>Mercollog /Kimist / Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)</u>	1 (një)
2	Kryekuzhinier	1 (një)
3	Kuzhinier	2 (dy)
4	Ndihmës Kuzhinier	2 (dy)
5	Punonjës shpërndarës ushqimesh	2 (dy)
6	Sanitar/e	2 (dy)
7	Shofer	1 (një)
	Total	11 (njëmbëdhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për drejtuesin teknik/ Përgjegjës shërbimi (Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor):

- Diplomë me profesionin perkates;
- Kontratë pune (e noterizuar), si drejtues teknik;
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 3 dy vite.
- Librezë shëndetësore e lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor, e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën kohore Dhjetor 2025 deri ne daten e zhvillimit te procedures.

b) Për kryekuzhinierin dhe Kuzhinierin:

- Diplomë ose çertifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kryekuzhinier/ kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.
- Librezë shëndetësore e lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor, e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën kohore Dhjetor 2025 deri ne daten e zhvillimit te procedures.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.
- Librezë shëndetësore e lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor, e cila duhet të jetë e vlefshme për periudhën kohore Dhjetor 2025 deri në datën e zhvillimit të procedurës.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe sanitaret të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi dhe sanitare/e (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për personel është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...” Kërkesa e autoritetit kontraktor për 2(dy) Kuzhinierë është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës objekt prokurimi, duke qënë se kuzhinierët janë të domosdoshëm për gatimin e produkteve të cilat do të shërbehen në vaktin e mëngjesit edhe të darkës shtresave në nevojë apo personave të cilët ndodhen në situatë rruge. Ushqimi në Qendrën komunitare “Strehëza” do të shkojë i gatuar paraprakisht dhe do të shërbehet për t’u konsumuar pranë kësaj qendre. Kërkesa e një punonjësi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka në stafin e tij punonjës me njohuritë e duhura profesionale për gatimin e ushqimit pasi ky është një proces shumë Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al sensitiv duke qënë se ushqimi është jetësor për personat e ndodhur në situatë rruge. Përsa i përket numrit dy kuzhinierë kjo është gjithashtu e domosdoshme pasi do të shërbehen dy vakte në ditë për 30 (tridhjetë) persona dhe i vetëm një kuzhinier nuk mund ta realizojë si shërbim. Referuar sa më sipër, ky kriter garanton AK për realizimin me sukses dhe në kohë të kontratës në tërësi. a) Kërkesa për të paktën 1 (një) merceolog ushqimi/teknolog ushqimor është i rëndësishëm pasi do të luajë një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen, sasinë në gramaturë, ruajtjen, përpunimin, paketimin, shpërndarjen dhe përdorimin e ushqimit të sigurt për personat në

situatë rruge konform standarteve në fuqi për sigurinë ushqimore. b) Kërkesa për të paktën 2 (dy) ndihmës /kuzhinier është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës objekt prokurimi, duke qënë se edhe ndihmës kuzhinierët janë të domosdoshëm për gatimin e produkteve të cilat do të shërbehen në vaktin e mëngjesit edhe të darkës shtresave në nevojë apo personave të cilët ndodhen në situatë rruge, pasi ata do të asistojnë kuzhinierët gjatë procesit të gatimit konform menuve të përcaktuara, sipas përcaktimit të bërë në termat e referencës. Ushqimi në Qendrën komunitare “Strehëza” do të shkojë i gatuar paraprakisht dhe do të shërbehet për t’u konsumuar pranë kësaj qendre. Kërkesa e një punonjësi garanton Autoritetin Kontraktor se, Operatori Ekonomik ka në stafin e tij punonjës me njohuritë e duhura profesionale për gatimin e ushqimit pasi ky është një proces shumë sensitiv duke qënë se ushqimi është jetësor për personat e ndodhur në situatë rruge. Përsa i përket numrit të ndihmës kuzhinierëve është vendosur duke mbajtur në konsideratë se do të shërbehen dy vakte në ditë për 30 (tridhjetë) persona për 365 ditë të vitit duke përfshirë edhe ditët e shtuna edhe të diela dhe i vetëm një ndihmës kuzhinier nuk mund ta realizojë si shërbim. c) Kërkesa për të paktën 2 (dy) punonjës shërbimi/shofer është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë edhe kjo me objektin e kontratës objekt prokurimi, duke qënë se, ata do të kryejnë transportimin e ushqimit konform përcaktimeve të bëra në termat e referencës nga ambjenti që disponon OE për përgatitjen e ushqimit pranë Qendrës Komunitare “Strehëza”. Ky transport do të realizohet dy herë në ditë për të dy vaktet dhe për këtë arsye kërkohet edhe që ofertuesit e mundshëm ekonomikë të disponojnë dy shoferë pasi ushqimi do të shkojë i gatuar paraprakisht dhe do të shërbehet për t’u konsumuar pranë kësaj qendre nga personat e ndodhur në situatë rruge. d) Kërkesa për të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për trajtimin, përpunimin, shpërndarjen, paketimin e produkteve shtazore dhe jo shtazore është e nevojshme lind e nevojshme pasi është një punonjës i certifikuar i specializuar në trajtimin, përpunimin, shpërndarjen, paketimin e produkteve shtazore dhe jo shtazore në mënyrë që ky shërbim të realizohet me sukses për më tepër që është një shërbim sensitiv sepse lidhet direkt me ushqimin që do të konsumohet dhe me rëndësi jetike për personat që u ofrohet ky shërbim. Kërkesa për qënësinë e tyre për një periudhë prej 3(tre) muaj në listpagesa është kërkuar për të garantuar AK se është një staf operativ i qëndrueshëm pranë OE dhe që garanton dhe krijon besueshmëri tek AK se, ky shërbim do të realizohet me sukses.

2.3.9 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 2 (dy) mjete transporti ATV (frigorifer) të cilat do të kryejnë transportin e produkteve ushqimore e frigoriferike për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

(a) Në rastet kur mjetet janë në pronësi: Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit; Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); certifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS).

Në rastet kur mjetet janë me qera: Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi; Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit; Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); certifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS).

(b) Leje higjeno-sanitare per automjetin, lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik e rrethit ku ushtron aktivitetin përkatës, e vlefshme për periudhën e realizimit të objektit të kontratës.

(c) Mjetet të cilat do të jenë me një tonazh mbi 1.5 ton duhet të pajisura me liçencë transporti.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të pika 4/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Mjeti i mësipërm është i domosdoshëm, pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Disponimi i Lejes higjeno-sanitare është e rëndësishme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se do të respektohen standartet për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit i cili do të transportohet drejt Qendrës Komunitare “Strehëza” për njerëzit në nevojë.

2.3.10 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë se produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit HACCP.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve të cilat duhet të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit HACCP.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **"Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca"**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali: Dokumentat e tenderit;

NJËSIA E PROKURIMIT

Arlinda Mucaj	Personi Përgjegjës (Drejtoria e Prokurimeve)
Dajana Piro	Specialist i fushës (Drejtoria e Prokurimeve)
Erblina Hysa	Specialist i fushës (Qendra Sociale Streheza Tiranë)